

## KONFERENCË SHKENCORE NË TIRANË KUSHTUAR LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT

Me rastin e 130-vjetorit të themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Instituti i Historisë-Tiranë, organizoi Konferencën Shkencore “Shqiptarët përballë sfidave të bashkimit dhe të lirisë”. Kjo veprimtari u zhvillua më 13 qershor 2008 në një nga sallat e Hotel Tirana International. Në konferencë morën pjesë studiues të shkencave albanologjike nga Shqipëria dhe Kosova, pedagogë të universiteteve, studentë, etj. Fjalën e hapjes e mbajti Drejtori i Qendrës së Studimeve Albanologjike, Prof. Dr. Ardian Marashi.

Pastaj u procedua me paraqitjen e kumtesave: “Lidhja e Prizrenit në kontekstin e marrëdhënieve shqiptaro-osmane” (Prof. Dr. Ferit Duka), “Nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit te Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë dhe Kosovës (Akad. Kristaq Prifti), “Lidhja Shqiptare e Prizrenit projekt për shtetin kombëtar” (Prof. Dr. Jusuf Bajraktari), “Epopeja e Skënderbeut dhe Rilindja Kombëtare Shqiptare” (Prof. Assoc. Dr. Luan Malltezi), “Vetëdija kulturore dhe politike e shqiptarëve në kohën Lidhjes së Prizrenit” (Prof. Dr. Pajazit Nushi), “Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe faktori ndërkombëtar” (Prof. Dr. Ksenofon Krisafi), “Koncepti i nacionalizmit shqiptar si fenomen historiografik” (Dr. Dritan Egro), “Të dhëna nga raportet konsullore austro-hungareze për Ymer Prizrenin” (Prof. Dr. Marenglen Verli), “Pashko Vasa dhe Lidhja e Prizrenit” (Prof. Dr. Gazmend Shpuza), “Figura e Abedin Dinos dhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit” (Dr. Shkëlzen Raça), “Lidhja Shqiptare e Prizrenit sipas konsujve francezë në Shkodër” (Prof. Dr. Fehmi Rexhepi), “Bashkëpunimi shqiptaro-grek dhe kursi politik i Megali-Idesë (1877-1878)” (Ma. Ledia Dushku), “Koncepti komb-shtet në Lidhjen e Prizrenit” (Ma. Sokol Gjermani), “Qëndrimi i konsujve anglezë në Prizren dhe Shkodër ndaj Lidhjes Shqiptare të Prizrenit” (Mrs. Frashër Demaj), “Lidhja Shqiptare e Prizrenit në faqet e gazetës *New York Times*” (Ma. Artan Hoxha), “Vështrim juridik rreth strukturave

institucionale të Lidhjes së Prizrenit (Esmiralda Osmani) dhe “Lidhja e Prizrenit në poezinë shqiptare” (Prof. Dr. Klara Kodra).

Ajo çka e dalloi këtë konferencë ishin spektri i gjërë tematik i trajtesave si dhe këndvështrimet e reja për disa çështje të rëndësishme që lidhen me dinamikën e marrëdhënieve shqiptaro-osmane gjatë viteve të Lidhjes së Prizrenit, jehonën e Lidhjes në shtypin amerikan të kohës, etj.

Vlerësimet përfundimtare për konferencën i paraqiti Prof. Dr. Jusuf Bajraktari, Drejtor i Institutit të Historisë së Prishtinës.

**Ferit DUKA**

### **KONFERENCË SHKENCORE NË PRISHTINË KUSHTUAR LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT**

Qershori i vitit 2008 shënon Jubileun e 130-të të formimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Me këtë rast nën patronazhin e Presidentit të Republikës së Kosovës, z. Fatmir Sejdiu, u organizuan një varg aktiviteteve shkencore e kulturore në shumë qytete të Kosovës. Madhështia e këtij jubileu kishte edhe një të veçantë-Shpalljen dhe njohjen ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës. Manifestimi qendror filloi më 9 qershor 2008, në Teatrin Kombëtar në Prishtinë ku u mbajt Akademia solemne kushtuar 130-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Me këtë rast, Presidenti Fatmir Sejdiu në fjalën e tij në mes tjerash theksoi “Lidhja e Prizrenit drejtoi edhe mesazhin bashkëpunues me të gjithë popujt dhe vendet liridashëse, të cilat ftoheshin të praninin ëndrrën e një populli, i cili merrte përsipër detyrimet dhe përgjegjësitë për të ardhmen e vendit të vet”.

Fjalë rasti mbajti edhe kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Akademik Rexhep Ismajli, i cili foli për rëndësinë politike dhe historike të LSHP.

Më 10 dhe 11 qershor në Prishtinë nën patronazhin e Presidentit Sejdiu, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës dhe Instituti i Historisë-Prishtinë, zhvilloi punimet Konferenca Shkencore:

“Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881”. Në Konferencë morën pjesë studiues nga Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, SHBA-të, Turqia, Austria, Jordani etj.

Fjalën e hapjes së Konferencës e mbajti Prof. dr. Jusuf Bajraktari drejtor i Institutit të Historisë në Prishtinë, i cili u shpreh se organizimi i kësaj konference shkencore ka për qëllim prezantimin e njohurive dhe afirmimin e vlerësimeve të reja për njërin nga ngjarjet më të rëndësishme për historinë kombëtare shqiptare.

Fjalë përshëndetëse në Konferencë mbajtën: Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë prof. dr. Enver Hoxhaj, i cili theksoi se programi politik dhe nacional i LSHP-së bazohej në tri shtylla kryesore: në pavarësi politike, tërësi politike e territoriale dhe në identitet kombëtar shqiptar.

Në vazhdim, punimet e Konferencës i përshëndeti edhe kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, akademik Rexhep Ismajli, i cili shprehu bindjen e plotë për rezultatet e pritura të studiuesve pjesëmarrës në konferencë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, akademik Teki Biçoku, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, theksoi se LSHP-ja e themeluar në Prizren nga personalitetet më të shquara shqiptare të asaj kohe, u shndërrua në një platformë politike mbarëshqiptare që e shtriu ndikimin në të gjitha viset shqiptare.

Në përfundim të fjalëve përshëndetëse të Konferencës, për punë të mbarë dhe sukses të plotë u shpreh edhe Dr. Ardian Marashi, drejtor i Qendrës Albanologjike në Tiranë.

Punimet e Konferencës u zhvilluan dy ditë dhe ishin të ndara në sesione. Sesionin e parë filloi me kumtesën e akademik Pajazit Nushit të titulluar “Vetëdija kulturore dhe politike e shqiptarëve në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”. Nushi foli në hollësi për rrethanat kulturore-historike në viset shqiptare në prag dhe gjatë LSHP.

Prof. dr. Jusuf Bajraktari në kumtesën e tij “Lidhja Shqiptare e Prizrenit, projekt për shtetin kombëtar” tha në mes tjerash se “një nga ngjarjet që i dha popullit shqiptar një përgjigje që zë vend nderi në histori është themelimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Pikërisht në kuvendet e Lidhjes dhe në veprimet e saj u afirmua ideja për projektin e shtetit shqiptar me orientime të qarta të qytetërimit perëndimor”.

Në vazhdim, akademik Kristaq Prifti u paraqit me kumtesën “Nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit te Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë dhe e

Kosovës”. Z. Prifti analizoi me pedantëri momentet më të rëndësishme të historisë kombëtare që nga Lidhja e Prizrenit e deri tek Pavarësia e Kosovës.

Prof. dr. Ferit Duka ligjëroi me temën “Lidhja Shqiptare e Prizrenit në kontekstin e marrëdhënieve shqiptaro-osmane”. Z. Duka bëri një analizë të detajuar të mbështetur në kronologjinë e ngjarjeve gjatë LSHP-së, deri te shtypja e saj nga forcat e Dervish Pashës.

Për rolin e italianëve në zgjimin kombëtar shqiptar 1878-1912, referoi studiuesi nga SHBA, Prof. Dr. Bernd Fischer, i cili spikati ndikimin dhe rolin e italianëve, posaçërisht të komunitetit arbëresh në ngritjen e ndjenjave kombëtare.

“Trajtimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në historiografinë sovjetike”, ishte kumtesa të cilën e trajtoi prof. dr. Zekeria Cana. Z. Cana vuri në pah qëndrimin dhe trajtimin tendencioz të historiografisë ruse për LSHP.

Studiuesi nga Stambolli prof. dr. Yüksel Çelýk në referatin e tij “Qëllimi i formimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”, u ndal në këndvështrimin nga i cili Porta e Lartë e shikonte LSHP-në.

Studiuesja nga Vjena, Ma. Eva Frantz, u paraqit me kumtesën “Roli i mirditorëve në konfliktin me Mehmet Ali Pashën në Gjakovë”. Znj. Frantz në mes të tjerash trajtoi edhe statusin social dhe fetar të fanëve katolik në rajonin e Prizrenit dhe Gjakovës.

Prof. dr. Fehmi Rexhepi në kumtesën “Lidhja Shqiptare e Prizrenit sipas konsujve francez në Shkodër”, duke u bazuar në dokumentet e Arkivit të Kosovës, vuri në dukje mospërputhjen e interesave franceze me pretendimet e popullit shqiptar.

Prof. dr. Luan Malltezi, në kumtesën “Epopeja e Skënderbeut dhe Rilindja Kombëtare Shqiptare” foli për frymëzimin që kishte ngjallur epoka skënderbegiane për kthimin e krenarisë kombëtare në periudhën e Rilindjes. Kurse prof. dr. Muhamed Mufaku në kumtesën e tij “Imazhi i Lidhjes Shqiptare në Lindjen e Mesme 1978-2008” trajtoi LSHP nga perspektiva e vendeve të Lindjes.

Prof. dr. Iljaz Rexha, në kumtesën me titull “Veprimtaria e degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Prishtinë” foli për aktivitetin e degës së LSHP në Prishtinë dhe kontributin e saj gjatë kohës së ekzistencës së saj.

Prof. dr. Marengelen Verli, në kumtesën “Të dhëna nga raportet konsullore austro-hungareze për Ymer Prizrenin” u ndal në trajtimin e

figurës atdhetare të Ymer Prizrenit sipas konsujve të Vjenës të akredituar në terren.

Dr. Dritan Egro foli për “Koncepti i nacionalizmit si fenomen historiografik” duke përfshirë fenomenin e nacionalizmit edhe në kohën e ekzistencës dhe veprimtarisë së LSHP.

Studiuesi Ma. Frashër Demaj referoi me temën “Qëndrimi i konsujve anglez në Prizren dhe Shkodër ndaj Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”. Në këtë temë u trajtuan qëndrimet dhe kontradiktat e konsujve anglez, veçanërisht qëndrimi i tyre ndaj LSHP.

Studiuesi Ma. Jusuf Buxhovi mbajti referatin e titulluar “Lidhja Shqiptare e Prizrenit në shtypin gjerman të kohës”. Z. Buxhovi ofroi të dhëna nga trajtimi i shtypit gjerman të kohës dhe qëndrimi i qeverisë gjermane ndaj çështjes shqiptare.

“Lidhja Shqiptare e Prizrenit sipas gazetës Gllas Crnogorca” ishte kumtesa e prof. dr. Isa Bicaj. Z. Bicaj parashtrroi qëndrimin e qeverisë malazeze dhe trajtimin që i bënte LSHP, gazeta malazeze “Gllas Crnogorca”

Studiuesi Qemajl Morina në kumtesën e tij “Lidhja Shqiptare e Prizrenit sipas revistës “Al Xhenan” të Bejrutit (1878-1881)” foli për jehonën e formimit të LSHP në vendet e Lindjes sipas revistës “Al Xhenan”.

Dr. Shkëlzen Raça, në kumtesën “Vilajeti i Janinës në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878-1881)” foli për rrethanat e përgjithshme në Vilajetin e Janinës në kohën e LSHP.

“Bashkëpunimi shqiptaro-grek dhe dilemat e Megali-Idesë (1877-1878)” ishte kumtesa e studiueses ma. Ledia Dushku. Znj. Dushku trajtoi pikat kryesore të bashkëpunimit shqiptaro-grek, interesat e dy popujve dhe pretendimet greke të shfaqura përmes “Megali Idesë”

Studiuesja ma. Albina Drançolli në kumtesën “Bisedimet sekrete në mes të Fuqive të Mëdha gjatë luftës ruso-turke 1877-1878” bëri një vështrim të interesave të Fuqive të kohës, të përpjekjeve për t’i realizuar ato.

Prof. dr. Lush Culaj u paraqit me kumtesën “Rivaliteti diplomatik në mes Austro-Hungarisë dhe Italisë në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”. Z. Culaj trajtoi në mënyrë të gjithanshme rivalitetin austro-hungarez në viset shqiptare.

Prof. dr. Nail Draga në kumtesën e tij “Çështja e Ulqinit në gjeopolitikën e Fuqive të Mëdha (1880)” foli për çështjen e Ulqinit dhe implikimin e Fuqive të Mëdha.

Dita e dytë e Konferencës Shkencore filloi me kumtesën e prof. dr. Muhamet Pirraku “Roli i fesë në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit”. Në këtë kumtesë u bë fjalë për fenë dhe rolin e saj në kohën e LSHP.

Prof. dr. Gazmend Rizaj në kumtesën e tij “Figura e Prenk Bib Dodës nga prizmi i diplomacisë angleze (1876-1878)”, vuri në dukje se roli i Prenk Bibë Dodës dhe kryengritjes së mirditorëve duhet parë si një reagim normal për kohën dhe jo si kundërvënie ndaj lëvizjes së Lidhjes së Prizrenit.

“Roli i Ymer Prizrenit në Lidhjen Shqiptare” ishte kumtesa e prof. dr. Xheladin Shalës, i cili u shpreh se “Ymer Prizreni është presidenti i parë i Shqipërisë etnike”.

Prof. dr. Daut Bislimi referoi me temën “Historiografia shqiptare për Lidhjen e Prizrenit”. Z. Bislimi bëri një përmbledhje të gjithanshme të historiografisë shqiptare për LSHP.

Prof. dr. Sabile Basha, në kumtesën “Lidhja Shqiptare e Prizrenit në programin e organizatave ilegale në Kosovë”, vuri në dukje se idetë dhe programi për çlirimin dhe bashkimin kombëtar i nisur nga Kuvendi i LSHP ka qenë pjesë e të gjitha programeve politike të organizatave atdhetare në Kosovë që nga viti 1945 e deri më 1990.

Referuesi i radhës dr. Riza Sadiku, në kumtesën “Shënimi i përvjetorit të Lidhjes së Prizrenit në mërgatën shqiptare në SHBA”, foli për shënimin e 80 dhe 100-vjetorit të LSHP në SHBA.

Për vlerat e ekspozitës së vitit 1978, kushtuar 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, foli prof. dr. Jusuf Osmani në kumtesën “Vlerat e Ekspozitës kushtuar 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”.

Radha e kumtesave të studiuesve në ditën e dytë të punimeve të Konferencës u përmbyll me studiuesin mr. Parim Kosova, i cili trajtoi kulturën materiale të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, duke përmendur ndërtesën e Postë-Telegrafit, kompleksin e gazit Mehmet Pashës, Kafën e Marashit etj.

Në përmbyllje pati diskutime rreth çështjeve, kumtesave dhe problemeve të ndryshme të cilat e karakterizuan Lidhjen Shqiptare të Prizrenit.

Në mbyllje të punimeve të Konferencës, kryetari i Këshillit Organizues prof. dr. Pajazit Nushi paraqiti fjalën e mbylljes. Z. Nushi pasi i bëri një rezymim zhvillimit të punimeve të Konferencës, konkludoi se Konferenca Shkencore “Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881)” ishte shumë e suksesshme, përgëzoi studiuesit për punën e tyre dhe rezultatet e reja shkencore të bëra publike me këtë rast.

**Frashër DEMAJ**



*Pjesëmarrës të Konferencës Shkencore në kompleksin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*